



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 59.5 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 23.08.2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit në mes të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës për Huazimin e Kamerave

- I. Miratohet Marrëveshja e Bashkëpunimit në mes të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës për Huazimin e Kamerave.
- II. Marrëveshja e Bashkëpunimit, si në pikën I është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 23.08.2021

Kryetar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve



Kreshnik Radoniqi



**Komisioni
Qendror
i Zgjedhjeve**



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission*



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

DHE

KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

“PËR HUAZIMIN E KAMERAVE PËR VIDEOREGJISTRIM”

E lidhur sot, më -----/-----/2021, me vullnet të lirë, të plotë e të pavarur midis palëve:

KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, me seli në
....., përfaqësuar nga, që më poshtë do të referohet si **huamarrësi**.

KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË me seli në
Tiranë sheshi “Skënderbej”, përfaqësuar nga, që më poshtë do të referohet si **huadhënësi**.

Neni 1

Baza Ligjore

Kjo marrëveshje hartohet bazuar në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 901-912 të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe akte të tjera që rregullojnë marrëdhëniet civile në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Objekti i Marrëveshjes

1. Objekt i kësaj marrëveshjeje është forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional (ndërshtetëror) dhe ndihmës reciproke midis palëve, për dhënien në huapërdorje të 50 (pesëdhjetë) kamerave për videoregjistrim, të cilat do t'i shërbejnë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës për zgjedhjet lokale 2021.
2. Kamerat për videoregjistrim jepen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) i Republikës së Shqipërisë, në përdorim, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) të Republikës së Kosovës, pa pagesë, në kuadër të bashkëpunimit të dy institucioneve publike, duke ju referuar letërkëmbimit ndërmjet palëve.
3. Specifikimet për për sasinë, llojin, vlerën dhe gjendjen teknike të kamerave hartohen nga personat e ngarkuar të palëve dhe pasqyrohen në proces-verbal.
4. Palët caktojnë personat e ngarkuar për dorëzimin e kamerave të vëzhgimit, jo më vonë se 10 ditë nga nënshkrimi i marrëveshjes.

Neni 3

Kohëzgjatja e përdorimit të kamerave të huazuara

1. Kamerat e vëzhgimit i jepen KQZ së Republikës së Kosovës në përdorim për procesin e numërimit në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, në kuadër të zgjedhjeve lokale të datës 17.10.2021 dhe raundit të dytë për kryetar komune.
2. Kamerat e huazuara do të kthehen, jo më vonë se 20 (njëzetë) ditë nga certifikimi i rezultateve.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrime e palëve nënshkruese të kësaj marrëveshje

1. KQZ e Republikës së Kosovës, në cilësinë e huamarrësit merr përsipër:
 - a) mirëmbajtjen e kamerave për videoregjistrim, të marra në dorëzim dhe përdorimin e tyre në bazë të objektit të kësaj marrëveshjeje;
 - b) përkujdesjen për ruajtjen e tyre nga vjedhjet, humbjet, zjarri apo çdo lloj dëmtimi tjetër.
 - c) transportin e tyre për në Kosovë dhe anasjelltas.
 - d) kthimin e tyre në gjendjen fizike e funksionale që i ka marrë në dorëzim nga KQZ e Republikës së Shqipërisë.
 - e) Kompensimin në para', në rast të humbjes apo dëmtimit të ndonjë kamere, një pjese të kamerës apo me shumë kamerave, ku çmimi referues do të merret çmimi i blerjes së njësisë/ve së identifikuar si e dëmtuar.
2. KQZ e Republikës së Shqipërisë, në cilësinë e huadhënësit merr përsipër:

- a) vendosjen në dispozicion të KQZ së Republikës së Kosovës përgatitjen e dokumentacionit që depozitohet në doganën e Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës.
- b) trajnimin e personelit të KQZ-së së Republikës së Kosovës për montimin, funksionalizimin dhe përdorimin e pajisjeve si dhe do t'i pajisë me udhëzuesit për përdorim.

Neni 5

Hyrja në fuqi dhe përfundimi i marrëveshjes

1. Marrëveshja hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.
2. Marrëveshja përfundon me mbarimin e afatit të vendosur nga palët në nenin 2 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 6

Dispozitat përfundimtare dhe përmbyllëse

1. Kjo marrëveshje interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
2. Korrigjimi i marrëveshjes, pas nënshkrimit të saj, bëhet vetëm me pëlqimin e dy palëve.
3. Secila palë gëzon të drejtën për të zgjidhur marrëveshjen përpara afatit, nëse ndonjëra prej tyre nuk përmbush detyrimet e marra përsipër.
4. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë mes dy palëve, në lidhje me interpretimin apo zbatimin e saj, do të zgjidhet me mirëkuptimin e tyre, në të kundërt, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
5. Marrëveshja përpilohet në 2 (dy) kopje, me vlerë të njëjtë ligjore, në gjuhën shqipe, një për secilën palë.

Datë: xx.08.2021

z. Ilirjan Celibashi
Komisioner Shtetëror i Zgjedhjeve
i Republikës së Shqipërisë

z. Kreshnik Radoniqi
Kryesues i Komisionit Qendror të
Zgjedhjeve i Republikës së Kosovës
